

VENDIM
Nr. 202, datë 10.4.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR LËSHIMIN E DOKUMENTEVE
LIGJORE PËR TRANSFERIMIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE
USHTARAKE DHE TË ARTIKUJVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË
DYFISHTË, QË LËSHOHEN NGA AUTORITETI I KONTROLLIT SHETËTOROR
TË EKSPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 341, datë 8.4.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr.1

Tarifat për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë

SHËRBIMI	TARIFA NË LEKË
1. Licencë individuale eksporti për mallra ushtarake	3 000
2. Licencë individuale për eksport të përkohshëm për mallrat ushtarake	3 000
3. Licencë individuale për riekспорт për mallra ushtarake	3 000
4. Licencë individuale importi për mallra ushtarake	3 000
5. Licencë individuale për import të përkohshëm për mallrat ushtarake	3 000
6. Licencë individuale për transit ndërkombëtar të mallrave ushtarake	3 000
7. Licencë individuale për <i>transship</i> ndërkombëtar të mallrave ushtarake	3 000
8. Licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese (<i>brokerage</i>) për mallrat ushtarake	3 000
9. Autorizim për negociim të marrëveshjeve	3 000

ndërkombëtare për mallra ushtarake për vendet nën embargo	
10. Certifikatë e regjistrimit për mallrat ushtarake	3 000
11. Certifikatë ndërkombëtare importi për mallra ushtarake	3 000
12. Certifikatë e përdoruesit të fundit për mallra ushtarake	3 000
13. Certifikatë e mbërritjes së mallit në destinacion (DVC) për mallra ushtarake	3 000
14. Licencë individuale eksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
15. Licencë globale eksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
16. Licencë individuale për eksport të përkohshëm për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
17. Licencë individuale për riekport për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
18. Licencë individuale importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
19. Licencë globale importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
20. Licencë individuale për import të përkohshëm për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
21. Licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese (<i>brokerage</i>) për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
22. Licencë individuale për transferim <i>software</i> ose të teknologjive nëpërmjet rrugëve elektronike	3 000
23. Licencë individuale për transit ndërkombëtar të artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë	3 000
24. Licencë individuale për <i>transship</i> ndërkombëtar të artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë	3 000
25. Licencë individuale për mallrat që nuk përfshihen në listën e miratuar për kontroll	3 000
26. Autorizim për negociim të marrëveshjeve ndërkombëtare për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
27. Certifikatë ndërkombëtare importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
28. Certifikatë e përdoruesit të fundit për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
29. Certifikatë e mbërritjes së mallit në destinacion (DVC) për artikujt dhe teknologjitë	3 000

me përdorim të dyfishtë	
30. Lëshim dublikate i licencës/ certifikatës/ autorizimit të dhënë	1 000